

Vendim nr. 260 datë 08.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 08.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (K) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KLODIAN RRJEPAJ**, përfaqësuar nga avokat Tritan Hamitaj, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-116, datë 25.01.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 27, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 135, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 436, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*); nenet 71, pika 3, shkronja “e” dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), në kuadër të procedimit penal nr. 13, datë 13.01.2020 (*nr. 13/2020*), të regjistruar për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim, “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të kryer në bashkëpunim dhe “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuara nga nenet 248 e 25, 258 e 25 dhe 260 të Kodit Penal (*KP*). Në vijim të hetimeve paraprake të këtij procedimi penal, në regjistrin e njoftimit të veprave penale, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar edhe veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim dhe “Mashtrimi”, në bashkëpunim me pasoja të rënda, të parashikuara nga nenet 186, paragrafi i tretë e 25 dhe 143, paragrafi i dytë dhe i tretë, të KP-së. Ajo prokurori ka regjistruar edhe emrat e autorëve të dyshuar të këtyre veprave, ndër të tjerë, edhe emrin e kërkuesit, ndërsa ky i fundit është dyshuar si autor i veprave penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafët e dytë dhe të tretë e 25, 186, paragrafi i tretë e 25, si edhe 248 dhe 25 të KP-së.

2. Objekt i hetimit janë veprimet/mosveprimet që lidhen me procedurën publike të finalizuar me kontratën e koncesionit të datës 10.12.2015 (*kontrata e koncesionit të sterilizimit*), me objekt dhënien me koncension/partneritet publik privat të shërbimit publik të ofrimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale, me afat 10-vjeçar dhe vlerë totale 9 657 000 000 lekë (pa tvsh), të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe shoqërisë “SaniService” sh.p.k., sikundër edhe me veprimet/mosveprimet në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate. Hetimi konsiston mbi dyshimet e ngritura për shkelje të ligjit për sa i përket: (i) procedurës së identifikimit të projektit të mundshëm të koncesionit/partneritet publik privat, nën dyshimin se studimi i fizibilitetit është në shkelje të kërkesave të ligjit duke pasqyruar të dhëna të rreme; (ii) procedurës së përgatitjes së dokumenteve standarde të tenderit/koncesionit, nën dyshimin e përcaktimit të kritereve të zgjedhjes dhe të dhënies së koncesionit në shkelje të kërkesave të ligjit duke paracaktuar fituesin; (iii) procedurës së zhvillimit të tenderit/koncesionit dhe shpalljes së fituesit, nën dyshimin e përzgjedhjes së fituesit të paracaktuar; (iv) procedurës së negociimit dhe lidhjes së kontratës së koncesionit, nën dyshimin e mospërputhjes së termave të saj me ato të dokumenteve standarde të tenderit/koncesionit në dëm të interesave të shtetit dhe në favor të shoqërisë koncesionare; (v) procesit të zbatimit të kontratës së koncesionit, nën dyshimin e shkeljes së termave të kontratës në dëm të interesave të shtetit dhe në favor të shoqërisë koncesionare.

3. Për sa i përket kërkuessit, ai ka qenë i ngarkuar me detyrën e zëvendësministrit të Shëndetësisë dhe të kryetarit të Komisionit të Dhënies me Koncesion/Partneritet Publik Privat (PPP). Në ushtrim të këtij funksioni, kërkuessi ka pasur si detyrë të përgatiste situatën e fizibilitetit të kontratës së koncesionit së sterilizimit, të përllogariste vlerën e saj dhe të përgatiste dokumentet standarde të koncesionit. Ai dyshohet se në kundërshtim me ligjin, megjithëse në dijëni të ekzistencës së strukturës për sterilizim dhe të instrumenteve kirurgjikale, ka vijuar me procedurën për koncesionin. Po ashtu ai dyshohet se si kryetar i komisionit ka vendosur miratimin e studimit të fizibilitetit për shërbime të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale në bazë të të dhënave të pasakta [...]. Në kryerjen e kësaj detyre, për kërkuessin është ngritur dyshimi se nuk është bërë asnjë studim i saktë për elementet përbërëse të kostos së këtij shërbimi, duke paraqitur të dhëna të pasakta për numrin, llojin apo kriteret për klasifikimin e kategorive të intensitetit të ndërhyrjeve në spitale që reflektohen në pasqyrat financiare, duke krijuar dëm në buxhetin e shtetit. Po ashtu, është ngritur dyshimi se nuk është bërë inventarizimi dhe vlerësimi i instrumenteve kirurgjikale dhe pajisjeve të sterilizimit, për të nxjerrë më pas nevojat reale për plotësimin e nevojave ose zëvendësimin total të tyre [...]. Për këto arsye, ai dyshohet se si anëtar i komisionit të dhënies së koncesionit dhe njëkohësisht zëvendësministër i Ministrisë së Shëndetësisë ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe detyrën e tij. Gjithashtu, kërkuessi dyshohet se nuk ka deklaruar konfliktin e interesit, në kushtet kur më herët ka pasur njohje me një prej ortakëve të shoqërisë fituese të koncesionit, konkretisht me shtetasin I.Rr.

4. Në vijim, Prokuroria e Posaçme i ka kërkuar gjykatës caktimin ndaj personave nën hetim të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, ku për kërkuessin ka kërkuar masën “Arresti në burg”, si i dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafët e dytë dhe të tretë e 25, 186, paragrafi i tretë e 25, si edhe 248 dhe 25 të KP-së. Mbi këtë kërkesë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 49, datë 23.06.2023, ndër të tjera, ka vendosur caktimin ndaj kërkuessit të masës “Arresti në burg”. Kjo masë sigurimi është ekzekutuar në datën 17.08.2023 dhe, në vijim, në përputhje me nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka marrë në pyetje kërkuessin e arrestuar me qëllim verifikimin e kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës, si dhe të nevojave të sigurimit. Në përfundim, me vendimin nr. 102, datë 18.08.2023, ajo gjykatë, ndër të tjera, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës “Arresti në burg” ndaj

kërkuesit. Kundër këtij vendimi, sikundër edhe atij për caktimin e masës së sigurimit, kërkuesi ka paraqitur ankim.

5. Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Apelit*), me vendimin nr. 44, datë 04.10.2023, ndër të tjera, ka vendosur miratimin e vendimeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për caktimin dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arrestit në burg” ndaj kërkuesit. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-116, datë 25.01.2024, ndër të tjera, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

6. Në datën 17.09.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se procesi gjyqësor për caktimin e masës së arrestit ndaj tij ka cenuar:

7.1. *Lirinë personale të garantuar nga nenet 27 dhe 17 të Kushtetutës*, pasi asnjë prej gjykatave nuk ka dhënë përgjigjen se pse çdo kusht dhe kriter do të duhet të çmohet si i nevojshëm për caktimin e kësaj mase sigurimi, në kushtet kur ndjekja penale ka nisur që në vitin 2020 dhe gjatë kësaj periudhe trevjeçare nuk rezulton që kërkuesi të ketë tentuar të arratiset, dëmtojë provat, kryejë vepra të tjera penale etj. Nga vendimet e gjykatave rezulton se pas rreth tre vjetësh ka ende kufuzion dhe paqartësi lidhur me veprën penale që i atribuohet kërkuesit, duke rënduar pozitën me vepra penale që nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën.

7.2. *Parimet e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi kërkuesi nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë në raport me të hetuarit e tjerë për të njëjtën çështje.

7.3. *Parimin e proporcionalitetit*, pasi në të gjitha shkallët e gjykimit është rënduar dhe paragjykuar pozita e kërkuesit si zëvendësministër dhe kryetar komisioni, si dhe nuk është vërtetuar se si kërkuesi e ka shfrytëzuar pozitën e tij funksionale dhe si lidhet ajo me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit. Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar shkaqet që e kanë çuar në marrjen e vendimit. Nuk është arritur të vërtetohet ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në

prova. Nuk është arsyetuar përshtatshmëria e masës së sigurimit “Arresti me burg”, referuar neneve 228 dhe 229 të KPP-së.

7.4. *Të drejtën për proces të rregullt, në drejtim të:*

7.4.1. *Së drejtës së mbrojtjes*, pasi Gjykata e Lartë njoftimin për gjykimin e çështjes së kërkuesit e ka bërë në faqen e saj të internetit 13 ditë përpara zhvillimit të saj, në kundërshtim me nenin 436, pika 3, të KPP-së, sipas të cilit njoftimi bëhet të paktën 30 ditë përpara.

7.4.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit se shpërdorimi i detyrës është një dispozitë që zbatohet kur fakti nuk mund të parashikohet në një dispozitë tjetër penale. Gjykata e Lartë kishte detyrimin të kontrollonte ligjshmërinë e akuzave të ngritura nga organi i akuzës. Konkretisht, nuk është kryer një analizë e thelluar e fakteve dhe kualifikimit juridik të veprave penale të cilat i janë ngarkuar kërkuesit. Duke mos analizuar shkeljet ligjore që janë konstatuar në lidhje me kërkuesin, Gjykata e Lartë ka rënduar pozitën procedurale të tij. Ajo duhej të kishte çmuar se veprat penale “Mashtrimi” dhe “Falsifikimi i dokumenteve” nuk duhet të konkurrojnë me njëra-tjetrën.

7.4.3. *Parimit të gjësë së gjykuar*, pasi një nga pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuesi ka të bëjë me faktin se ai nuk mund të gjykohet për të njëjtin fakt penal për të cilin është gjykuar me vendimin e formës së prerë të datës 19.09.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur pushimin e çështjes. Ndërkohë, arsyetimi që i ka bërë Gjykata e Lartë këtij pretendimi bie në kundërshtim me vetë praktikën unifikuese të asaj gjykate dhe jurisprudencën kushtetuese. Gjykata e Lartë nuk ka analizuar aspektin procedural të “pushimit” në raport me dispozitat e tjera të KPP-së, për sa i përket rishikimit të vendimeve dhe jurisprudencës kushtetuese dhe të GJEDNJ-së.

7.4.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike*, pasi gjykatat në arsyetimin e tyre kanë vepruar në kundërshtim me nenet 7, 128 dhe 449 të KPP-së. Edhe arsyetimi që ka bërë Gjykata e Lartë nuk qëndron. Gjykata e Lartë, në ndryshim nga praktika e saj e mëparshme, nuk është shprehur në asnjë moment për llojet e veprave penale që i janë atribuar kërkuesit dhe nuk ka dhënë asnjë sugjerim ose orientim për prokurorinë apo gjykatat më të ulëta se si duhej të trajtohej raporti ndërmjet këtyre veprave. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të

kërkuesit, siç është ai i konfliktit të interesit të kërkuesit me të bashkakuzuarin tjetër I.Rr., i cili nuk qëndron. Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar në lidhje me studimin e fizibilitetit të prokurimit publik, por vetëm ka pranuar arsyetimin e bërë nga gjykatat më të ulëta. Ajo gjykatë nuk ka analizuar drejt përgjegjësinë penale të kërkuesit në raport me dyshimin e arsyeshëm bazuar në prova, si dhe kushtet e kriteret për caktimin e masës së sigurimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

10. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, që mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor. Megjithatë, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen konkrete, Kolegji konstaton se kërkuesi kundërshton vendimin e Gjykatës së Lartë që nuk ka pranuar rekursin e tij dhe që në thelb ka konfirmuar vendimmarrjen e gjykatave të faktit për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, ndaj në këto rrethana ai nuk ka mjet tjetër ankimi në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual, rrjedhimisht e ka përmbushur edhe këtë kriter të legjitimitimit.

12. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në këtë kuptim, Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 25.01.2024, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në datën 17.09.2024. Ndërkohë, nga komunikimi me Gjykatën e Lartë, ajo informon se vendimi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 27.05.2024, që do të thotë se ky është momenti kur kërkuesi konsiderohet se ka marrë dijeni efektivisht për vendimin objekt kundërshtimi. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

14. Në lidhje me kriterin e legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se është cenuar parimi i *barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, duke e lidhur atë me argumentin se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë në raport me të hetuarit e tjerë për të njëjtën çështje. Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë përpara ligjit nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përliqet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se kërkuesi nuk ka sjellë asnjë argument konkret se si nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me të hetuarit e tjerë dhe nuk ka arritur të provojë nga pikëpamja kushtetuese pretendimi i tij në drejtim të parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës së mbrojtjes*, duke argumentuar se Gjykata e Lartë njoftimin për gjykimin e çështjes e ka bërë në faqen e saj të internetit 13

ditë përpara zhvillimit të saj, në kundërshtim me nenin 436, pika 3, të KPP-së, sipas të cilit njoftimi bëhet të paktën 30 ditë përpara.

17. Në rastin konkret Kolegji vëren se referuar faqes së internetit të Gjykatës së Lartë rezulton se kjo e fundit në datën 11.01.2024 ka realizuar shpalljen e gjykimit të çështjeve për t'u gjykuar në datën 25.01.2024, ku përfshihej edhe çështja e kërkuarit, duke njoftuar edhe përbërjen e trupit gjykues. Po ashtu, Kolegji konstaton se kërkuari nuk mohon të ketë marrë dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë. Pretendimi i tij lidhet drejtpërdrejt me mënyrën se si është realizuar njoftimi, duke theksuar mungesën e njoftimit të paktën 30 ditë përpara, sipas përcaktimit të nenit 436, pika 3, të KPP-së. Në këto rrethana, Kolegji sjell në vëmendje jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 30, datë 18.04.2024; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 30, datë 19.05.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se mosshpallja nga Gjykata e Lartë e datës, orës dhe përbërjes së trupit gjykues në faqen e saj të internetit, sipas përcaktimit të nenit 436, pika 3, të KPP-së, nuk përbën shkelje të tillë, ku si pasojë kërkuarit t'i jetë cenuar e drejta substanciale e mbrojtjes, për të cilën ai nuk ka sjellë asnjë argument ose provë për të vërtetuar se në ç'mënyrë i është cenuar ajo. Gjykata e Lartë, nëpërmjet shpalljes në faqen e saj të internetit të datës, orës dhe përbërjes së trupit gjykues, sipas përcaktimit të nenit 436 të KPP-së, e ka kryer detyrimin e saj për garantimin e zhvillimit të një procesi të rregullt në respektim të elementeve të tij. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes është i pabazuar.

19. Po ashtu, sipas kërkuarit është cenuar edhe *parimi i gjësë së gjykuar*, pasi arsyetimi që i ka bërë Gjykata e Lartë pretendimit të tij për cenimin e gjësë së gjykuar, bie në kundërshtim me vetë praktikën unifikuese të asaj gjykate dhe jurisprudencën kushtetuese.

20. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më sipër, referuar argumenteve të paraqitura nga kërkuesi në mbështetje të pretendimit të tij për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar, konstatohet se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, si të tilla nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Për rrjedhojë, vërehet se ai nuk është argumentuar nga pikëpamja kushtetuese, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

22. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Kolegji vë në dukje se kërkuesi, në thelb, ka pretenduar cenimin e lirisë personale për shkak të caktimit ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, ndërsa ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka lënë në fuqi vendimet e gjykatave më të ulëta që kanë caktuar ndaj tij masën shtrënguese të sigurimit personal “Arresti në burg”, të dhënë gjatë procesit gjyqësor në drejtim të garancive që ofron e drejta për proces të rregullt, duke pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, si dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike. Referuar argumenteve të kërkuesit në lidhje me pretendimet për proces të rregullt, Kolegji konstaton se ato kanë të bëjnë me mënyrën e arsytimit të gjykatave në dhënien e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, ndaj duke mbajtur në konsideratë thelbin e argumenteve dhe rrethanat e çështjes, pretendimet e kërkuesit do të analizohen në drejtim të kufizimit të lirisë personale në raport me parimin e proporcionalitetit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, sipas garancive të normuara në nenet 17, 27 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

B. Për pretendimin e cenimit të lirisë personale në raport me parimin e proporcionalitetit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij dhe nuk ka kryer një analizë të thelluar të fakteve dhe kualifikimit juridik të veprave penale të cilat i janë ngarkuar atij. Sipas tij, Gjykata e Lartë duhej të kishte çmuar se veprat penale “Mashtrimi” dhe “Falsifikimi i dokumenteve” nuk duhet të konkurrojnë me njëra-tjetrën. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë, në ndryshim nga praktika e saj e mëparshme, nuk është shprehur në asnjë moment për llojet e veprave penale që i janë atribuar atij dhe nuk ka dhënë asnjë sugjerim ose orientim për prokurorinë apo gjykatat më të ulëta se si duhej të trajtohej raporti ndërmjet këtyre veprave. Ndërkohë, sipas kërkuesit, asnjë prej gjykatave nuk ka dhënë përgjigjen se pse çdo kusht dhe kriter duhej të çmohej si i nevojshëm për caktimin e masës së sigurimit të vendosur ndaj tij, në kushtet kur ndjekja penale ka nisur që në vitin 2020 dhe gjatë kësaj periudhe trevjeçare nuk rezulton që ai të ketë tentuar të arratiset, dëmtojë provat, kryejë vepra të tjera penale etj. Sipas tij, në të gjitha

shkallët e gjykimit është rënduar dhe paragjykuar pozita e tij si zëvendësministër dhe kryetar komisioni, si dhe nuk është vërtetuar se si ai e ka shfrytëzuar pozitën e tij funksionale dhe si lidhet ajo me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit. Në përfundim, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar shkaqet që e kanë çuar në marrjen e vendimit, nuk ka arritur të vërtetojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, si edhe nuk ka arsyetuar përshtatshmërinë e masës së sigurimit “Arresti me burg”, referuar neneve 228 dhe 229 të KPP-së.

24. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj (*pika 2, shkronja “c”*).

25. Gjykata ka pohuar se qëllimi kryesor i kësaj dispozite është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike. Në këtë kontekst, “dyshimet e arsyeshme” për kryerjen e veprës penale, që justifikojnë kufizimin e lirisë personale të individit, nënkuptojnë ekzistencën e fakteve ose informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale. Thënë kjo, çdo kufizim i lirisë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e mbrojtjes së individëve nga arbitrariteti dhe se ai do të konsiderohet arbitrar, midis të tjerash, në rastet kur nuk është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur. Ndërsa, mosbërja e një hetimi të vërtetë nga ana e autoriteteve mbi faktet e çështjes, për të verifikuar nëse kufizimi i lirisë është bërë mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm, do të përbente cenim të nenit 27 të Kushtetutës. Për të vlerësuar nëse është respektuar standardi i dyshimit të arsyeshëm që kërkohet për arrestimin e një individi, mbahet në konsideratë konteksti i përgjithshëm i fakteve të çështjes, duke përfshirë këtu edhe statusin/personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi dhe sjelljen e autoriteteve. Në këtë rast, disa shkaqe që konsiderohen të pranueshme për të justifikuar paraburgimin janë: a) rreziku që i dyshuari/akuzuari, në qoftë se do të lihej i lirë, do të largohej dhe nuk do të paraqitej përpara gjykatës, i cili vlerësohet nën dritën e faktorëve të tillë që lidhen me personalitetin (e të akuzuarit/pandehurit), banesën, punën, pasuritë, lidhjet familjare dhe çdo lidhje tjetër me vendin ku zhvillohet procesi penal; b) rreziku që i dyshuari/akuzuari, në qoftë se do të lihej i lirë, do të ndërmernte veprime për të penguar dhënien e drejtësisë; c) rreziku që i dyshuari/akuzuari, nëse do të lihej i lirë, do të kryente vepra penale të tjera, që do të thotë se rreziku duhet të jetë i besueshëm nën dritën e

rrethanave të çështjes, historikut dhe personalitetit të të dyshuarit. Këto rreziqe duhet të tregohen me argumente thelbësore dhe arsyetimi i gjykatave për këto çështje nuk mund të jetë abstrakt, i përgjithshëm ose stereotip. Në këtë kuptim, ka pranuar Gjykata, vendimi nëse ka pasur ose jo cenim të nenit 27 të Kushtetutës merret bazuar në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që kanë disponuar për caktimin e masës së kufizimit të lirisë (*shih vendimin nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se në funksion të përmbushjes së standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Nën optikën e normave dhe standardeve kushtetuese të elaboruara si më lart, vihet në dukje se në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, kushtet, kriteret dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP. Kështu, referuar kushteve të përcaktuara në nenin 228 të këtij kodi, askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova (*pika 1*) dhe ato vendosen: i) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; ii) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; iii) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet (*pika 3*). Për sa u përket kriterëve të përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal, sipas nenit 229 të KPP-së, në caktimin e tyre gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret (*pika 1*) dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Në këtë rast mbahen parasysh vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga KP-ja (*pika 2*). Për sa u përket kriterëve të veçanta për caktimin e masës "Arresti në burg", sipas nenit 230 të KPP-së, ajo mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të të pandehurit (*pika 1*).

28. Në analizë të rrethanave të rastit konkret, Kolegji do të shqyrtojë nëse pretendimet e kërkuesit për kufizimin e lirisë për shkak të caktimit ndaj të tij të masës së sigurimit personal "Arresti në burg" janë haptazi të (pa)bazuara për t'u trajtuar në seancë plenare. Për këtë qëllim, Kolegji do të analizojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar

(jo)mjaftueshëm në lidhje me ekzistencën e *dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova*, si dhe të njërit prej këtyre shkaqeve: ekzistencës së *shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës*; kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; kur për shkak të *rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të tjera*, duke mbajtur në konsideratë *kontekstin e përgjithshëm të fakteve të çështjes dhe nëse ajo haptazi nuk duket/është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur*.

29. Në rastin konkret Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë, pasi ka shqyrtuar aktet e dosjes gjyqësore dhe shkaqet e rekursit, ka argumentuar se nuk konstatohen shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së për cenueshmërinë e vendimmarrjes së Gjykatës së Posaçme të Apelit. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi i rekursuar është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural penal, konkretisht të neneve 228, 229 dhe 230 të KPP-së, në lidhje me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, si dhe vendimit unifikues nr. 7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ndryshe nga sa pretendohet në rekursin e paraqitura nga personat nën hetim, përfshirë edhe kërkuesin, sipas Gjykatës së Lartë vendimi i kundërshtuar është i argumentuar dhe i ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara nga të. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykata e apelit ka argumentuar mjaftueshëm ekzistencën e *dyshimit të arsyeshëm se fakti penal i hetuar ka ndodhur dhe rekursuesit janë disa nga personat e përfshirë në ardhjen e pasojave/dëmtimin e interesave ekonomike të shtetit dhe të shtetasve*. Për kërkuesin, Gjykata e Lartë ka pasqyruar argumentet e gjykatës së apelit, sipas të cilave kërkuesi, në cilësinë e zëvendësministrit të Shëndetësisë dhe si kryetar i Komisionit të Dhënies me Koncesion/PPP ka vepruar në kundërshtim me këtë detyrë, duke vepruar në kundërshtim të hapur dhe flagrant me aktet ligjore dhe nënligjore; nuk ka deklaruar praninë e konfliktit të interesit, në kushtet kur më herët se procedura e koncesionit ka pasur njohje me një nga ortakët e firmës fituese, shtetasin I.Rr.; pasojat e veprave penale të kryera nga kërkuesi nuk janë vetëm ekonomike, por lidhen edhe me cilësinë e shërbimit jetik, sikurse është sterilizimi i sallave operatore, që lidhet drejtpërdrejt me shëndetin e pacientëve dhe kjo shton rrezikshmërinë e faktit dhe të autorëve.

30. Gjithashtu, Gjykata e Lartë e ka gjetur bindës, logjik dhe të arsyetuar vendimmarrjen e gjykatave të faktit si në lidhje me ekzistencën e *dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova*, për kushtet e përgjithshme e të veçanta të nenit 228 të KPP-së, ashtu edhe në lidhje me identifikimin dhe llojin e masave më e përshtatshme. Sipas Gjykatës së Lartë, nevoja e caktimit të një mase sigurimi për kërkuesin nën hetim është e pranishme, për sa kohë ekziston dyshimi i arsyeshëm se mund të ketë kryer veprat penale për të cilat dyshohet

(referuar analizës shteruese dhe provave të marra e të verifikuara deri në këtë fazë të hetimit nga gjykatat e posaçme/gjyqtari i hetimit paraprak). Ndërsa pretendimet e mbrojtjes në lidhje me rrethanën e bashkëpunimit, me ekzistencën e këtyre figurave të veprave penale apo konkurrimi mes tyre në raport me faktet penale për të cilat po hetohen të dyshuarit, do të verifikohen edhe në vijim në një fazë tjetër të këtij procedimi penal. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se sikurse të hetuarit kanë një cilësi tjetër, atë të “personit në hetim”, duke iu atribuar edhe një akuzë konkrete mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme mbështetur në provat se kanë konsumuar disa vepra penale, duke pasur parasysh rëndësinë e fakteve dhe bashkëpunimin e secilit të hetuar në kryerjen e tyre, çdo masë tjetër *in melius* është e papërshtatshme për t’u vendosur ndaj tyre, duke analizuar ekzistencën e rrezikut të ndikimit mbi vijimësinë e hetimit, pasi rrezikshmëria e veprave penale të cilat i atribuohen të hetuarve deri në këto momente është e një shkalle të lartë. Nga ana tjetër, asnjë prej veprave nuk rezulton të jetë shuar, për shkak të ndonjë shfuqizim dispozite apo amnistie, si dhe për personat nën hetim nuk konstatohet asnjë shkak padënueshmërie për efekt të ligjit penal. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat e posaçme kanë mbajtur në konsideratë edhe kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 229 të KPP-së, kanë verifikuar dhe analizuar në vështrim të kërkesave të neneve 48 e 50 të KP-së, në raport me gjendjen ku është ky procedim penal, nevojat e sigurimit, si dhe rrethana të tjera që lidhen me personalitetin e të hetuarve; rrethanat në të cilat ata kanë vepruar apo bashkëvepruar në kryerjen e veprës; rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprës penale; llojin dhe shkallën e pasojave të ardhura nga kryerja e veprës, llojin e shkallën e fajësisë dhe motivet për kryerjen e veprës; sjellja e autorit si para ashtu edhe pas kryerjes së veprës, si dhe rrethanat e tjera të jetës individuale, familjare e sociale të secilit prej tyre. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vendimmarrja e gjykatave të posaçme të faktit është marrë në zbatim të drejtë të legjislacionit penal (material dhe procedural) dhe se pretendimet në tërësi të ngritura në rekurs nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e gjykatave të faktit, të përcaktuara në nenin 432 të KPP-së.

31. Për sa më lart, Kolegji vëren se gjykatat e posaçme dhe Gjykata e Lartë, në vlerësimin për masën e sigurimit personal të arrestit në burg ndaj kërkuesit, kanë dhënë argumentet përkatëse mbi bazën e të cilave kanë disponuar për kufizimin e lirisë së tij, dhe nëse ajo ishte e “mjaftueshme” për të arritur qëllimin për të cilën ishte kërkuar. Konkretisht, sipas tyre, ekziston dyshimi i arsyeshëm që kërkuesi të ketë kryer veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryera në bashkëpunim, pasi jo vetëm që nuk është bërë asnjë studim i saktë për elementet përbërëse të kostos së këtij shërbimi, me të

dhëna të pasakta mbi numrin, llojin apo kriteret për klasifikimin e kategorive të intensitetit të ndërhyrjeve në spitale që reflektohen në pasqyrat financiare, duke krijuar dëm në buxhetin e shtetit, por edhe se nuk është bërë inventarizimi dhe vlerësimi i instrumenteve kirurgjikale dhe pajisjeve të sterilizimit, për të nxjerrë me pas nevojat reale për plotësimin e nevojave ose zëvendësimin total të tyre. Sipas gjykatave, edhe pasojat e veprave penale për të cilat akuzohen të hetuarit nuk janë vetëm ekonomike, por lidhen edhe me cilësinë e shërbimit jetik, sikurse është sterilizimi i sallave operatore që lidhet drejtpërdrejt me shëndetin e pacientëve dhe kjo shton rrezikshmërinë e faktit dhe të vetë të hetuarve, përfshirë kërkuesin. Mbështetur në këto fakte, ato kanë analizuar mjaftueshëm mbi dyshimin e arsyeshem për kryerjen e veprës penale, sikundër edhe ekzistencën e kushteve të veçanta për caktimin e masave të sigurimit personal. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka pasqyruar argumente edhe në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit personal, duke parashtruar gjerësisht arsyet se përse nevojat e sigurimit në rastin konkret diktonin caktimin ndaj kërkuesit të masës së arrestit në burg, duke vlerësuar njëkohësisht si të papërshtatshme çdo masë tjetër sigurimi personal (*in melius*). Thënë këto, vendimi objekt kundërshtimi nuk cenon kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor.

32. Nën këtë këndvështrim, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit për kufizimin e lirisë personale për shkak të caktimit të masës së sigurimit personal të arrestit në burg të lidhur me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë janë haptazi të pabazuara, në kushtet kur masa është vendosur për një qëllim të ligjshëm, që është garantimi i mbarëvajtjes së procesit penal në ngarkim të tij, nuk duket të jetë joproporcionale në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe në raport me veprën penale për të cilën ai akuzohet, si dhe është në përputhje me rregullat procedurale të KPP-së për caktimin e kësaj mase.

33. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.